



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

---

Numri i lëndës: 2018:063790

Datë: 03.04.2024

Numri i dokumentit: 05539395

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ - Departamenti i Përgjithshëm, divizioni penal,** me gjyqtarin e vetëm gjykues Dardan Maloku, me zyrtaren ligjore Ardita Tasholli, në çështjen penale ndaj të pandehures E.T.G., me vendbanim në ...c, rruga “...” lagja katër, ndërtesa ..., apartamenti numër ..., për shkak të veprës penale Shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm nga neni 365 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1 të Kodit Penal 04/L-082 të Republikës së Kosovës (tani e tutje KPRK-së), sipas Aktakuzës të paraqitur nga Prokuroria Themelore në Ferizaj – Departamenti i Përgjithshëm, PP/II.nr.1234-5/2018 të datës 16.10.2018, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor, të hapur për publikun, më datë 26.03.2024, në të cilën kanë marrë pjesë prokurori i shtetit Avdullah Abedini, prokuror në Prokurorinë Themelore në Ferizaj, e pandehura E.T.G. me mbrojtësin e saj me autorizim av. Bahtir Troshupa dhe i dëmtuari Sh.Q., më datë 26.03.2024, mori dhe publikisht shpalli, kurse më datë 03.04.2024 përpiloi këtë:

**A K T G J Y K I M**

**Të akuzuarit:**

**E.G. (T.),** nga i ati F. dhe ëma I., e gjinisë A. e lindur me datë ..., në P., me vendbanim në ..., rruga “...” lagja katër, ndërtesa ..., apartamenti numër ..., me numër personal ....., dhe numër te pasaportës .... lëshuar nga MPB – Republika e Shqipërisë, ka te kryer shkollën e mesme, e martuar, nënë e një fëmije të mitur, e gjendjes së dobët ekonomike, shqiptare, shtetase e Republikës së Shqipërisë.

**Ë S H T Ë F A J T O R E**

## Sepse:

Më datë 05.04.2018, rreth orës 08:00, të mëngjesit në Ferizaj në rrugën “...” nga pakujdesia ka rrezikuar jetën e njerëzve apo pasurinë e tyre, ashtu që në dhomën ku ka qenë duke banuar me qira, në banesën pronë e të dëmtuarit Sh.Q., pas ndaljes së rrymës ka lënë nxehësen elektrike duke mos e ç’kyqur dhe duke mos e siguruar mirë me kabllon ku e ka pasur të vendosur nxehësen duke e vendosur në një vazhdues tjetër të kualitetit të dobët të prizave dhe kabllon ku dhe ka ardhur deri te shkaktimi i zjarrit nga i cili zjarr dëme materiale të konsiderueshme ka pësuar banesa e të dëmtuarit Sh.Q., duke filluar nga dhoma ku ka qenë nxehësja elektrike si pikënisja e zjarrit i cili është zgjeruar në dhomat te t’jera deri te përhapja edhe në një pjesë të kulmit, me ç’rast kishte shkaktuar zjarr dhe rrezik për jetën e njerëzve dhe pasurin e njerëzve.

-Me këtë ka kryer veprën penale **Shkaktim i rrezikut të përgjithshëm** nga neni 365 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së.

Andaj gjykata në bazë të neneve 4, 7, 8, 17, 23, 41, 43, 46, 73, 74 dhe 365 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së, si dhe neneve 364, 452, 455 paragrafi 1 dhe 462 të Kodit të Procedurës Penale (KPP-së), të pandehurën e:

## GJYKON

- I. Dënim me gjobë në shumën prej 800 (tetëqind) euro, të cilin dënim e pandehura është e obliguar ta paguajë brenda afatit prej 60 (gjashtëdhjetë) ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- II. Nëse e pandehura nuk mundet apo nuk dëshiron ta paguajë dënimin me gjobë, të njëjtit në pajtim me nenin 43 paragrafi 3 të KPRK-së, dënimi me gjobë do ti zëvendësohet me dënim me burgim, ashtu që për 20 (njëzetë) euro gjobë të papaguara, i pandehuri do të vuajë 1 (një) ditë burgim.
- III. I dëmtuari Sh.Q. për realizimin e kërkesës pasurore - juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridiko - civil.
- IV. Obligohet e pandehura që ti paguaj shpenzimet e procedurës penale dhe atë në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 (njëzet) euro si, për fondin e kompensimit të viktimave të dhunës shumën prej 20 (njëzet) euro si dhe për shpenzimet lidhur me ekspertizën e elektros shumën prej 100 (njëqind) euro,

brenda afatit prej 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

## A R S Y E T I M

### **1.Rrjedha e çështjes dhe fjala përfundimtare**

Prokuroria Themelore në Ferizaj – Departamenti i Përgjithshëm ka ngritur aktakuzën PP/II.nr.1234-5/2018 të datës 16.10.2018, ndaj të akuzuarës E.T.G., për shkak të veprës Shkaktim i rrezikut të përgjithshëm nga neni 365 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së.

Në aktakuzë e pandehura identifikohet me mbiemrin T. mirëpo gjatë zhvillimit të procedurës penale e njëjta e ka ndryshuar mbiemrin në G.

Prokurori i shtetit në fjalën e tij përfundimtare në shqyrtim gjyqësor ka deklaruar se: gjatë shqyrtimit gjyqësor të çështjes penale kundër të pandehurës E.G.- T., e akuzuar për veprën penale shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm nga neni 365 në procedurën e provave personale dhe atyre materiale, në cilësinë e të dëmtuarit është dëgjuar Sh.Q., i cili në mënyrë të detajuar ka shpjeguar rastin, respektivisht që të pandehurës ja ka dhënë në shfrytëzim banesës e tij, e cila ka qenë e gatshme për banim, e po ashtu ka deklaruar edhe se me banesën e tij deri sa ka qenë duke banuar e pandehura ka ndodhur një zjarr dhe si pasojë ka pësuar dëme materiale. Si prova materiale janë administruar Deklarate e të dëmtuarit e dhënë në prokurori me datë 03.10.2018 dhe në polici me datë 11.04.2018; Deklarata e të pandehurës e dhënë në polici me datë 05.04.2018; Raporti mbi zjarrin i datës 05.04.2018 i hartuar nga drejtoria për shërbime publike dhe emergjente; Raporti fillestar i incidentit i datës 05.04.2018; Deklarata e të dëmtuarit e dhënë në polici Sh.Q. e datës 05.04.2018; Raporti i oficerit i datës 05.04.2018; Raporti i këqyrjes së vendit të ngjarjes nga Njësia e Forenzikes e datës 05.04.2018; Kontrata mbi qiranë e banesës me numër të referencës .../2017 e datës 21.09.2017 e lidhur në mes Sh.Q. dhe E. T.; Ekspertiza nga ekspertit i elektros e datës 18.03.2024, po ashtu në seancën e sotme të këtij shqyrtimi gjyqësor, në cilësinë e ekspertit të elektros lidhur me shakatarin e zjarrit, i njëjti deklaroi se shakatar është nxemësja në formë të radiatorit, e cila ka qenë e kyqur në rrymë përmes një kabllo vazhduese, i njëjti ka ardhur në përfundim duke i shfrytëzuar provat materiale që janë pjesë e lëndës po ashtu ka qenë edhe vet në vendin e ngjarjes, pas momentit që është angazhuar në cilësinë e ekspertit, po ashtu i njëjti deklaroi se dëmtime nga rryma nuk

ka pasur asnjë siguresë e as në kablo të rrymës, po ashtu një fakt të rëndësishëm eksperti e sqaroi edhe po të kishte ardhur si shkak i tensionit të lartë të rrymës, nuk ka mundur të shkaktohet kjo pasojë, nga mbrojtja e të pandehurës nuk është kontestues faktin se e njëjta ka marr në shfrytëzim me qira banesën nga i dëmtuari dhe e njëjta ka qenë me kushte të mira të banimit dhe se për ngrohje ka pasur të instaluar nxehtësinë e instaluar në muri, por ka pasur edhe një nxehtësi – kalorifer, në formë të radiatorit, të cilën e ka shfrytëzuar për ngrohje në dhomën e saj të gjumit dhe është ngrohur vetëm me këtë nxehtësi edhe e njëjta sa ka qenë jashtë banesës e ka kuptuar nga personat e tjerë se në këtë banesë ka zjarr dhe është kthyer në banesë dhe ka hyrë vetëm në korridorin e banesës ngase për shkak të tymit nuk ka mundur të hyj brenda nga këto prova konsiderojmë se me veprimet e të pandehurës manifestohen elementet e veprës penale që e ngarkon kjo aktakuzë, ngase kjo vepër ashtu siç është përshkruar në dispozitiv të aktakuzës, kryhet dhe në rastin konkret është kryer nga pakujdesia, andaj mbetemi në tërësi pranë aktakuzës dhe i propozojmë gjykatës që të pandehurën ta shpall fajtores në kuptim të nenit 351 i propozojmë gjykatës që të pandehurës ti shqiptohet një dënim me gjobë në lartësi prej 2,000 euro, duke pasur parasysh edhe dëmin e shkaktuar në banesë dhe rrezikshmërinë e veprës penale që është shkaktuar me rastin e ndezjes së zjarrit në banesë

I dëmtuari në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se e mbështes fjalën përfundimtare të prokurorit të shtetit dhe paraqes kërkesë pasurore juridike.

Mbrojtësi i të pandehurës në fjalën përfundimtare ka deklaruar se: sipas mendimit të komisionit ndërkombëtar të juristëve tekstualisht është thënë se sundimi i ligjit është më tepër se sa përdorimi formal i instrumente ligjore, është mbrojtës i anëtareve nga përdorimi i dhunës shtetërore, në rastin konkret instrumentet juridike as formalisht nuk janë zbatuar, sepse si rezultat i veprimeve të personave pa kompetencë profesionale, të ashtuquajture zyrtar të emergjencës dhe hartuesit e raporteve policore, nuk i kanë përmbushur detyrat sipas ligjit e në rastin konkret udhëheqja apo mbikëqyrja e hetimeve hetimore nga prokuroria totalisht ka dështuar, sepse nuk është autorizuar hetimi i vendit të ngjarjes nga eksperti i energjisë elektrike, si rezultat i dështimeve në veprime hetimore e që u konstatua edhe nga ekspert i energjisë elektrike se nuk ka mostra dhe nuk ka prova të mjaftueshme dhe i vetmi burim për ekspertim ka qenë kabloja e radiatorit, në këtë kontekst S.S., rezulton se është e pabazuar akuza, andaj në këtë rast të akuzuarës duhet ti jepet pa fajësi sepse me veprimet e saj as individualisht e as kumulativisht nuk është krijuar figura e veprës penale për të cilën akuzohet. Nga deklarata e të dëmtuarit – dëshmitarit Sh.Q. dhe nga kontrata për qiranë në mes Sh.Q. dhe

E.T. rezulton se banesa ka qenë e mobiluar sipas standardit dhe të gjitha pajisjet kanë qenë pronë e të dëmtuarit Sh.Q.. Nga eksperti u konstatua se kabllot e radiatorit kanë qenë të trashësisë njësia matëse  $3 \times 1.5 \text{ mm}^2$  dhe standardet optimale janë  $3 \times 2.5 \text{ mm}$ , në këtë rast shkaktimi i zjarrit nëse është shkaktuar nga kabllot sipas ekspertizës, përgjegjësia nuk bie mbi të akuzuarën, sepse ajo nuk ka qenë furnizuesi me kabllot. Rezulton i pa bazuar konstatimi i ekspertit se nuk ka pasur mbi tension të rrymës siç është përshkruar në faqen 3 pasuesi 2 dhe këtë konstatim e ka arsyetuar me faktin se po të kishte mbi tension do të digjeshin pajisjet në banesa tjera por eksperti nuk e ka ditur faktin se në atë objekt banim ende i pa banuar vetëm e akuzuara dhe të gjitha banesa tjera kanë qenë të zbrazura dhe nuk ka pasur pajisje të tjera, andaj bazuar në konstatimin e pjesës të ekspertizës faqe 5 pasuesi 6 ka theksuar se po supozojmë se nuk ka pasur dhe ka ardhur rryma me tension të lartë ato të cilat edhe i kemi konstatuar, ky konstatim kalon mundësinë e interpretimit që zjarri është shkaktuar si rezulton i mbi tensionit, andaj duke marr për bazë faktin se edhe nëse zjarri është shkaktuar nga radiator, nga elaborimi i ekspertit është vërtetuar se sa do që gjatë të jetë në rrym, radiator nuk krijon zjarr automatikisht ndalet, substancë ka vajin dhe ujin e vetmja mundësi është eksplodimi e në rastin konkret nuk kemi eksplodim, edhe nëse zjarri është shkaktuar nga kabllot siç e kam theksuar gjatë marrjes në pyetje të dëshmitarit ku kam kërkuar informacion për gjendjen e materialit shpenzues të rrymës dhe në mungesë të projektit për instalimin e rrymës pasi që projekti i instalimit nuk ekziston sepse investitori nuk ka ditur që të kërkohet, kryhet nga specialist të specializuar të cilët e përcaktojnë llojin, sasinë, kushtet dhe specifikacionin teknik që duhet ta kenë pajisjet elektrike në raport me fuqinë, kapacitetin dhe numrin e anëtarëve që shfrytëzojnë, dëshmitari Sh.Q. ka dëshmuar se rrymën e ka instaluar një kushëri dhe është konstatuar se i njëjti nuk ka licencë, në këtë kontest rezulton se nëse nuk është fajtor tensioni i lartë i energjisë elektrike, respektivisht KEDS-i atëherë përgjegjëse është investitori, mund të jetë instaluesi i rrymës dhe furnizuesi me material e në asnjë mënyrë përgjegjësi as objektive e as penale nuk bart e akuzuara, atëherë sipas ligjit kërkojmë aktgjykim lirues. Fakti që punëdhënësi ku ka punuar e akuzuara e ka bërë kompensimin e dëmit ndaj të dëmtuarit, kjo rrethanë nuk e ngarkon nga aksepti juridiko-penal, sepse ai këtë e ka bërë me qëllim humanizmi ndaj të dëmtuarit dhe thjeshtë nga frika e pasojave fizike të integritetit të akuzuarës dhe ky kompensim nuk është bërë nga e akuzuara, sepse nuk ka pasur përgjegjësi, andaj ne nuk e përdorim këtë si rrethanë lehtësuese që është kompensuar i dëmtuari por kërkojmë aktgjykim lirues. Nga refuzimi i provave për dëgjimin e dëshmitarëve jemi kufizuar në vërtetimin e pa fajësisë, sepse dëshmitari A.F. që është eksperti i energjisë elektrike dhe ka qenë i njoftuar me rastin sepse ka intervenuar dhe me dëshmitarët tjerë do të vërtetohej arsyeja e kompensimit të

demit nga personat të cilët e kanë kompensuar të dëmtuarin. Pasi që ekspertiza ka dështuar i propozojmë gjykatës nëse nuk shpall aktgjykim lirues ta përsëritë procesin gjyqësor, të dëgjojmë dëshmitarët dhe të nxjerr aktgjykim lirues.

E pandehura në fjalën përfundimtare ka deklaruar se: e mbështes fjalën e avokatit tim dhe kërkoj nga gjykata që ta merr një aktgjykim të drejtë.

## **2.Provat e administruara**

- Dëshmia e të dëmtuarit – dëshmitarit Sh.Q.;
- Dëshmia e ekspertit të elektros I.C.;
- Si dhe janë administruar provat materiale: Deklarata e të pandehurës e dhënë në Polici me datë 05.04.2018, Deklarata e të dëmtuarit - dëshmitarit Sh.Q. e dhënë në prokurori me datë 03.10.2018 dhe në polici me datë 05.04.2018 dhe 11.04.2018, Raporti i Shërbimeve Publike të Emergjencës-Shërbimi zjarrfikës dhe shpëtimit në Ferizaj i datës 05.04.2018, Raporti fillestar i incidentit me numër të rastit 2018-CF-542 i datës 05.04.2018, Raporti i oficerit i datës 05.04.2018, Raporti i këqyrjes së vendit të ngjarjes nga Njësia e Forenzikës i datës 05.04.2018; Kontrata mbi qiranë e banesës me numër të referencës .../2017 e datës 21.09.2017 e lidhur në mes Sh.Q. dhe E.T., Ekspertiza nga ekspertit i elektrose e datës 18.03.2024 dhe Foto Albumi i vendit të ngjarjes i cili përmban 5 (pesë) fletë të formatit A4 me fotografi nga vendi i ngjarjes i datës 05.04.2018.

Gjykata ka refuzuar propozimin që në cilësi të dëshmitarit të ftohet A.R. dhe A.F. pasi që sa i përket dëshmitarit të propozuar A.R., i njëjti nga asnjëra nga palët nuk është përmendur si person që ka qenë prezent në momentin kur ka ndodhur zjarri e as si person që e ka parë dikush në momentin e ndodhur të zjarrit, gjithashtu edhe dëshmitari i propozuar A.F. mund të jetë me profesion elektrikist mirëpo i njëjti nuk kemi dëshmi se ka bërë ndonjë kontroll në banesën kur ka ndodhur zjarri dhe nuk është përmendur as në deklaratën e të pandehurës të dhënë në polici dhe rrjedhimisht gjykata ka konstatuar se këta persona nuk mund të na ofrojnë ndonjë informacion të rëndësishëm sa i përket kësaj çështje juridike – penale.

### **2.1. Deklarata e të dëmtuarit – dëshmitarit Sh.Q.**

I dëmtuari - dëshmitari Sh.Q. në seancën e shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se: unë e njoh personin me emrin E.T., pasi që e njëjta ka qenë qiramarrëse e banesës sime në rrugën “...” në

Ferizaj, banesa është në katin e dytë ku i ka dy dhoma, sallon dhe kuzhinë bashkë. E di që e pandehura ka punuar në lokalin poshtë banesës sime ku me sa e di ka qenë lokal i lojërave të fatit, ku ajo e ka marrë banesën me qira me ndërmjetësim të A.R., ku data nuk më kujtohet saktë, por e kam në shtëpi kontratën për qira, e cila është lidhur në mes meje dhe tani të pandehurës dhe e njëjta është e lidhur te noteri Selatin në Ferizaj, nuk e di saktësisht përmbajtjen e kontratës sa i përket detyrave, por sa i përket shpenzimeve publike, ujë, rrymë ka pasur me i paguar e pandehura dhe nuk kemi pasur kohë të caktuar për kontratën, ku e njëjta ka qëndruar në këtë banës për afërsisht një vit e gjysmë. Asnjëherë nuk kam pasur ankesë nga e pandehura – qiramarrësja për ndonjë prishje apo për ndonjë problem tjetër lidhur me banesën dhe kur është marr banesa me qira e njëjta ka qenë e mobiluar përveç gjërave personale që i ka marr me vete e pandehura. Ngrohja në banesë ka qenë përmes sistemit të ngrohjes qendrore me kaldo elektrike, mirëpo e pandehura nuk e ka përdorur këtë ngrohje, ndërsa është ngrohur me ngrohëse të thjeshtë – nxemese elektrike, ndërsa nuk jam i sigurt, por mendoj që nxemesja ka qenë e imja, mirëpo tani po më kujtohet se nxemesja ka qenë e saj dhe këtë nxemese e ka përdorur për shkak të shpenzimeve më të lira. Unë kam shkuar që ta kontrolloj se a janë të gjitha gjërat në rregull në banesë disa herë prej kohës kur ja kam dhënë banesën me qira deri në momentin kur ka ndodhur rasti dhe ajo ka qenë prezent çdo herë që kam shkuar unë për me bërë kontrollin e banesës dhe nuk ka pasur kurrfarë problemi. Banesa nuk është kolektive është banim individual familjar, ku e kam unë me familjen time. Unë nuk kam jetuar në këtë banës në vitin 2018, por vajza ime ka jetuar në katin e parë. Në orët e hershme të mëngjesin fqinjët më kanë njoftuar me telefon se po kallet banesa dhe kulmi ka marr flakë pas eksplozimit të dritareve dhe kur kam ardhur unë nga fshati ..., për rreth 10 minuta, aty kishin ardhur zjarrfikësat, unë u tmerrova prej pamjeve që i pash dhe jemi munduar me vëllezërit dhe gjithë familjen me ju ndihmuar zjarrfikësit për me shkym zjarrin dhe zjarri është lokalizuar shume vonë ku janë derdhur disa cisterna me ujë, ku zjarrfikësit kanë menduar që ka banor aty dhe në atë objekt i kanë thyer edhe tri dyer të banesave të tjera, unë aty nuk kam qenë aty por kam qenë ne fshatin ....., por askush nuk më ka thënë që ka pasur ndërprerje të rrymës në atë kohë. Pasi u fik zjarri unë kam hyre brenda në banës dhe kam parë gjithçka zi, e djegur, e shkrumbuar, ndërsa unë nuk kam arritur me pa se ku ishte burimi i zjarrit, unë nuk kam pasur njohuri nëse në banës e pandehura ka qenë duke shfrytëzuar një nxemese me njëmbëdhjetë brinjë të sistemit me ulje dhe rrymë. Demin saktësisht nuk mund ta di, por e di se është diku mbi rreth 10,000 euro, pagesën e dyerve, dritareve, laminatit dhe trajtë e kulmit i ka bërë menaxheri i të pandehurës A.R. dhe shumën nuk e di pasi që ai e ka pasur marrëveshje me firmën “K.M.”, për afërsisht duhet të jetë mbi 4,000 euro dhe ky 4000 euro hynë në kuadër të

10,000 euro që nënkupton se pjesa tjetër e ka pa paguar edhe 6,000 euro. Banesa është me leje ndërtimore, ku përfshihet edhe projekti për rrymën pasi që leja nuk ipet pa e pasur të rregulluar çështjen e rrymës ndërsa nuk e kam dokumentin e pranimit teknik të objektit. Instalimin e rrymës e ka bërë E.Q., i cili ndodhet në perëndim, të cilën e kam kushëri dhe i njëjti e ka të përfunduar shkollën e mesme për instalim të rrymës dhe të njëjtën punë e bën edhe në Gjermani, ndërsa unë nuk e di se i njëjti a ka licencë për veprimtari të tille në Kosovë, pajisjet për rrymë i kam blere unë me rekomandim të E. dhe këto i kam blerë në dyqanet që merren me shitblerjen e këtyre pajisjeve. Cilësia ka qenë më e mira e mundshme dhe e gjitha ka qenë e prodhuesit I., pasi që këtë banesë e kam ndërtuar për familjen time. Unë nuk kam pasur problem me askënd dhe nuk dyshoj te askush që ma ka djegur banesën, unë mendoj që shkaktari që është djegur banesa është pakujdesia e të pandehurës pasi që e ka lënë në prizë nxehësen elektrike dhe nuk ka qenë prezent aty.

## **2.2 Deklarimi i ekspertit I.C.:**

Eksperti i elektros në dëshminë e tij në shqyrtim gjyqësor deklaroi: lidhur me këtë rast unë kam përpiluar një ekspertizë nga lëmia e elektros dhe qëndroj në tërësi pranë kësaj ekspertize, ndërsa sa i përket arsytimit të kam dhënë me shkrim, ndërsa dua të shtoj se sa i përket renditjes së fotografive, jam munduar të bëjë një renditje kronologjike nga epiqendra e zjarrit e tutje. Radiatori është hermetikisht i mbyllur, brenda në të është një nxemes dhe vaj dielektrik, i pa ndezshëm, dhe pikën e ndezjes e ka shumë të lartë, më të lartë se të naftës edhe nëse ka shkëndija elektrike – xhixha, ai vaji brenda radiatorit e shuan harkun elektrik dhe nuk ndizet dhe ka mungesë oksigjeni që nuk ka mundësi që të digjet dhe në bazë të statistikave në Kosovë asnjë rast nuk ka ndodhur që te digjet nga radiatori, pasi që kur djegia bëhet nga radiatori ka eksplodim dhe ka qenë e pa mundur të dëgjohet dhe kish pasur pasoja më të mëdha dhe kishte lënë gjurmë. Edhe termostati edhe ndërprerësi e kanë funksionin e njëjtë, mirëpo termostati funksion në mënyrë automatike, ndërsa ndërprerësi në mënyrë manuale, ndërsa dua të shtoj se në rastin konkret nuk ka pasur tension të lartë. Në bazë të raportit të forenzikës, por edhe në bazë të raportit emergjencës e kam konstatuar se ka pasur kablllo vazhduese, por edhe në bazë të fotografisë. Për konstatimin që e kam dhënë me shkrim jam i bindur 100 % që është i saktë, jam bazuar në dy metoda, në metodën deduktive dhe induktive dhe bëhet duke i eliminuar supozimet, e në rastin konkret supozimet se ka pasur tension të lartë, dua të shtoj se tension të lartë te nxemesja elektrike nuk manifestohen në asnjë mënyrë pasi që fillimisht manifestohet te pajisjet elektronike dhe në rastin konkret do te reagonte ndërprerësi i parë, i dytë ose i tretë,



ndërsa sa i përket radiatorit nëse këputet nxemësja dhe prek në metal te radiator, radiator ose do të saldohet të shkrihet dhe të del vaji, mirëpo në rastin konkret kjo nuk ka ndodhur. Kjo ekspertizë bëhet pas 6 viteve dhe për këtë përdoren metoda induktive, sepse nuk mund të bëhet ekzaminim direkt i kabllor dhe të studios e njëjta sepse përndryshe po ta kisha kabllon fizikisht do ta kisha studiuar dhe e kam vizituar vendin e ngjarjes dhe kabllot në mur nuk janë djegur dhe siguresat funksionojnë edhe tani dhe kjo nënkupton problemi ka qenë vetëm te kabllor vazhduese e nxemeses dhe duke u bazuar në raportin e policit hetues dhe deklaratat e Sh.Q. dhe E.T.. Kabllot në treg që përdorën tek ne janë 3x1.5 mm<sup>2</sup> dhe 3x2.5 mm<sup>2</sup> që në tregun tonë shumica janë 3x1.5 mm<sup>2</sup> dhe në rastin konkret ka qenë me diametër 3x1.5 mm<sup>2</sup>, ndërsa për kapacitetin e kësaj nxehtë kabllor është dashur me qenë 3x2.5 mm<sup>2</sup>. Për mua pasi që kam qenë edhe në vend të ngjarjes instalimi ka qenë profesional. Po të kishte qenë shkaktar tensioni i lartë atëherë do të shpërndahej zjarri në tërë ndërtesën përnjëherë dhe instrumentet elektronike do të pëlcisnin menjëherë. Aq më e gjatë të jetë kabllor vazhduese aq më e trashë duhet të jetë kabllorja, problemi ka qenë te kontakti ku lidhet kabllorja vazhduese dhe atë te spinat femërore.

### **3. Mbrojtja e të akuzuarës**

E pandehura në mbrojtjen e saj të paraqitur në shqyrtim gjyqësor ka deklaruar: fillimisht dua të theksoj se nuk qëndroj pranë deklaratës së dhënë në polici pasi të njëjtën e kam nënshkruar pa e lexuar dhe e kam nënshkruar në gjendje të rëndë emocionale ndërsa sa i përket rastit dua të shtoj se unë në vitin 2018, unë kam banuar në banesën e Sh.Q. dhe aty kam qenë me qira dhe kam jetuar me bashkëjetuesin tim E.A. shtetas turk dhe e kemi pasur edhe një qenush, ku bashkëjetuesi im u zgjua dhe shkoi në punë rreth orës 06:30, kurse unë mora mbeturinat që ishin në ballkon dhe zbrita poshtë i dërgova mbeturinat dhe u ktheva në punë në katin e parë të banesës për të pirë kafe me kolegun e punës rreth orës 07:00- 07:30, ku pastaj pronari i një furre të bukës aty afër na njoftoj se po del tym nga banesa ku isha duke qëndruar unë, u ngjita lart sepse doja të shpëtoja qenin, mirëpo tymi nuk më lejoj që të hyja brenda, ndërsa A.F. i kishte lajmëruar zjarrfikësit, ku zjarrfikësit vijnë për 20 minuta, brenda atyre 20 minutave kanë ardhur bashkëjetuesi im, pronari i vendit ku punoja, ndërsa nuk më kujtohet saktë ora kur ka ardhur tani i dëmtuari, unë nuk e di shakatarin e zjarrit, pasi data ka qenë 5 Prill dhe nuk ka qenë ftohët dhe unë nuk e mbaj nxehtë hapur, sepse kam probleme me frymarrjen, por e di se në atë periudhë ka pasur shpesh luhatje të tensionit dhe gjithmonë kam lajmëruar te puna, ndërsa të dëmtuarin nuk e kam lajmëruar pasi që nuk kam pasur kontakt me të, sepse punëdhënësi im A.A. i ka paguar të gjitha detyrimet, pasi u fik zjarri dhe qeni shpëtoj unë

shkova në polici për të dhënë deklaratë. Nxehtësia dhe të gjitha pajisjet tjera që kanë qenë në banesë, kanë qenë pronë e të dëmtuarit Sh.Q. dhe unë zakonisht fle në temperaturë të ulët, po thamë minimale, në banesë kam hyrë pasi ka ndodhur zjarri dhe unë bashkë me E. dhe me A.F. e kemi pastruar veturën dhe me sa kam mundur ta vërej kabllo në mure kanë qenë të dëmtuara, A. e ka kompensuar tani të dëmtuarin Sh.Q. dhe ja ka kthyer banesën në gjendjen e mëparshme, nuk e di saktësisht termet e punës dhe hollësitë, mirëpo e di që kur ke hy në atë banesë gjendja ka qenë si me parë dhe këtë nuk e kam parë me sytë e mi, mirëpo e them nga thëniet e ish kolegeve. Kur kam hyrë në banesë pasi ka ndodhur zjarri, kam vërejtur se dhoma e gjumit ishte djegur komplet, ndërsa pjesa tjetër e apartamentit ishte nxierë nga tymi ku në sallon kishte nxirje më shumë, kablo nuk kam parë të vendosur në prizë, përveç kabllos të nxehtësisë dhe këto pajisje kanë qenë të apartamentit, nuk kanë qenë asnjëra pajisjet e mia. Banesa ka qenë e gatshme për banim dhe nuk ka pasur ndonjë prishje. Ka pasur nxehtë qendrore mirëpo nuk e kam përdorur dhe kam përdorur kaloriferin – radiatorin apo nxehtësinë dhe për nxehtësinë kam përdorur kablo vazhduese. Para këtij rasti nuk ka pasur zjarr por ka pasur shkëndija tek priza e sobës në kuzhinë dhe kam lajmëruar tek puna Labinotin, ndërsa mbiemrin nuk ja di, por këto shkëndija nuk kanë shkaktuar ndonjë zjarr sepse kam qenë prezent dhe kam hequr prizën e sobës direkt. Nxehtësia ka qenë e fikur, ka qenë në prizë, por butoni ka qenë i fikur.

#### **4. Vlerësimi dhe analizimi i provave**

Në seancat e shqyrtimit gjyqësor në këtë çështje penale gjykata bazuar në nenet 7 dhe 360 të KPP-së, saktësisht dhe në mënyrë të plotë vërtetoi faktet që janë të rëndësishme për marrjen e vendimit të ligjshëm, me vëmendje dhe përkushtim maksimal dhe me përkujdesje të njëjtë vërtetoi faktet kundër të akuzuarit si dhe ato në favor të tij duke i mundësuar të njëjtit shfrytëzimin e të gjitha fakteve dhe provave që janë në favor të mbrojtjes dhe me ndërgjegje vlerësoi çdo provë një nga një dhe në lidhje me provat tjera dhe në bazë të vlerësimit të tillë ka nxjerr përfundimin lidhur me faktet konkrete të vërtetuara me ç'rast pas analizimit dhe vlerësimit të provave të cilat janë administruar në seancën e shqyrtimit gjyqësor ka ardhur në përfundim se në këtë çështje penalo juridike është vërtetuar përtej dyshimit të bazuar mirë se e akuzuara e ka kryer veprën penale Shkaktim i rrezikut të përgjithshëm nga neni 365 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së.

Nuk ishte kontestuese nga asnjëra nga palët se e akuzuar ka banuar me qera në vitin 2018 në banesën e të dëmtuarit Sh.Q. në Rr. “...” në Ferizaj.

Raporti fillestar i incidentit me numër të rastit 2018-CF-542 i datës 05.04.2018 dhe Raporti i oficerit i datës 05.04.2018, nuk janë prova që kanë peshë në vërtetimin e kësaj çështje juridiko-penale, të njëjtat janë të rëndësishme në konstatimin e veprimeve procedurale.

Nga kontrata mbi qiranë e banesës me numër të referencës .../2017 e datës 21.09.2017 e lidhur në mes Sh.Q. dhe E.T., gjykata gjeti se e akuzuara ka qenë qiramarrëse në banesën e të dëmtuarit dhe në bazë të pikës 2.4. të kontratës ka qenë e detyruar që me rastin e lirimit të banesës , të njëjtën banesë ta kthej në gjendjen e mëparshme ashtu edhe siç e ka pranuar.

Gjykata ia fali besimin Raportit të Shërbimeve Publike të Emergjencës-Shërbimi zjarrfikës dhe shpëtimit në Ferizaj i datës 05.04.2018, dhe nga i njëjti gjeti se zjarri është shkaktuar përafërsisht rreth orës 08:00, ku nga banesa ishte larguar para pak minutave banuesja E.T. e cila kishte zbritur afërsisht 10-15 minuta para rënies së zjarrit për të pirë kafe. Ekipi i zjarrfikësve ka intervenuar me shpejtësi për të lokalizuar zjarrin duke mos e lenë të përhapet pasi që kishte rrezik të përhapej edhe në pjesët tjera të banesave dhe objektit tjetër ngjitur me objektin e përfshirë në zjarr. Si shkaktar i zjarrit ka qenë ngrohësja elektrike e kyqur në rrymë.

Gjykata ia fali besimin Raportit të këqyrjes së vendit të ngjarjes nga Njësia e Forenzikës i datës 05.04.2018, nga i cili gjykata gjeti se zjarri kishte filluar në dhomën e fjetjes, ku në atë dhomë kishte pasur të vendosur për nxemje e dhomës një radiator me brinjë e cila ishte vendosur në rrymë.

Nga 5 (pesë) fletë të formatit A4 me fotografi nga vendi i ngjarjes i datës 05.04.2018 gjykata gjeti se në banesën e të dëmtuarit nga zjarri i shkaktuar janë shkaktuar dëme materiale.

Gjykata ia fali besimin e plotë dëshmisë së të dëmtuarit në cilësinë e dëshmitarit Sh.Q. dhe nga dëshmia e të njëjtit gjykata gjeti se ngrohja në banesë ka qenë përmes sistemit të ngrohjes qendrore me kalldo elektrike, mirëpo e pandehura nuk e ka përdorur këtë ngrohje, ndërsa është ngrohur me ngrohëse të thjeshtë – nxemese elektrike dhe këtë nxemese e ka përdorur për shkak të shpenzimeve më të lira, i njëjti nuk ka jetuar në këtë banesë në vitin 2018, por vajza e tij ka jetuar në katin e parë. Në orët e hershme të mëngjesin fqinjët e kanë njoftuar me telefon se po digjet banesa dhe kulmi ka marr flakë pas eksplozimit të dritareve dhe kur ka ardhur nga fshati ..., për rreth 10 minuta, aty kishin ardhur zjarrfikësit.

Gjykata ia fali besimin e plotë ekspertizës së ekspertit të elektros I.C. dhe deklarimit të tij në shqyrtim gjyqësor dhe nga të njëjtat gjykata gjeti se kablli vazhdues i nxemëses elektrike ka qenë i kualitetit të dobët dhe jo me seksion adekuat për fuqinë e radiatorit elektrik. Epiqendra e fillimit të zjarrit është kontaktet elektrike në kutinë e kabllor vazhduese dhe më pastaj pas zgjerimit të zjarrit energjia elektrike ka mundur të ndërpritet qoftë në mënyrë automatike qoftë nga njeriu. Problemi ka qenë vetëm te kabllor vazhduese e nxemëses dhe kabllot në treg që përdorën tek ne janë  $3 \times 1.5 \text{ mm}^2$  dhe  $3 \times 2.5 \text{ mm}^2$  që në tregun tonë shumica janë  $3 \times 1.5 \text{ mm}^2$  dhe në rastin konkret ka qenë me diametër  $3 \times 1.5 \text{ mm}^2$ , ndërsa për kapacitetin e kësaj nxehtë kabllor është dashur me qenë  $3 \times 2.5 \text{ mm}^2$ . Në vend të ngjarjes instalimi ka qenë profesional dhe nuk ka pasur tension të lartë. Po të kishte qenë shkaktar tensioni i lartë atëherë do të shpërndahej zjarri në tërë ndërtesën përnjëherë dhe instrumentet elektronike do të pëlcisnin menjëherë. Aq më e gjatë të jetë kabllor vazhduese aq më e trashë duhet të jetë kabllorja, problemi ka qenë te kontakti ku lidhet kabllorja vazhduese dhe atë te spinat femërore.

Gjykata ia fali pjesërisht besimin mbrojtjes së të akuzuarës të dhënë në shqyrtim gjyqësor dhe nga e njëjta gjeti se e akuzuari ditën kritike kishte qenë në banesë dhe nga rreth orës 07:00-07:30, kishte zbritur në katin e parë të banesës për të pirë kafe me një koleg të punës dhe nxehtësia elektrike kishte qenë në dhomën e gjumit në banesë, e vendosur në prizë përmes një kabllor vazhduese dhe të pandehurën e kishte njoftuar pronari i një furre aty afër se nga banesa po del tym. Ndërsa nuk ia fali besimin deklarimit se ka pasur luhatje të tensionit të energjisë elektrike pasi që edhe nga ekspertiza nga eksperti i elektros është konstatuar se nuk ka pasur luhatje të tensionit.

## **5.Gjendja faktike e vërtetuar**

Më datë 05.04.2018, rreth orës 08:00, të mëngjesit në Ferizaj në rrugën “...” nga pakujdesia ka rrezikuar jetën e njerëzve apo pasurinë e tyre, ashtu që në dhomën ku ka qenë duke banuar me qira, në banesën pronë e të dëmtuarit Sh.Q., pas ndaljes së rrymës ka lënë nxehtësinë elektrike duke mos e ç’kyqur dhe duke mos e siguruar mirë me kabllon ku e ka pasur të vendosur nxehtësinë duke e vendosur në një vazhdues tjetër të kualitetit të dobët të prizave dhe kabllor ku dhe ka ardhur deri te shkaktimi i zjarrit nga i cili zjarr dëme materiale të konsiderueshme ka pësuar banesa e të dëmtuarit Sh.Q., duke filluar nga dhoma ku ka qenë nxehtësia elektrike si pikënisja e zjarrit i cili është zgjeruar në dhomat te tjera deri te përhapja edhe në një pjesë të kulmit, me ç’rast kishte shkaktuar zjarr dhe rrezik për jetën e njerëzve dhe pasurin e njerëzve.

Neni 365 paragrafi 1 i KPRK-së përcakton se: *“Kushdo që me anë të zjarrit, vërshimeve, armëve, eksplozivit, helmit ose gazit helmues, rrezatimit jonizues, forcës mekanike, me energji elektrike ose me ndonjë lloj energjie tjetër, ose me ndonjë veprim tjetër të rrezikshëm apo mjete të rrezikshme, shkakton rrezik të madh për jetën e njerëzve apo dëm të konsiderueshëm pasuror, dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.* Kurse paragrafi 6 i po të njëjtit nen përcakton se: *“Nëse vepra penale nga paragrafi 1. ose 2. i këtij neni kryhet nga pakujdesia, kryesi dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet”.* Zjarr, në kuptim të këtij inkriminimi, paraqet stuhia e zjarrit e që zgjerohet në mënyrë të pakontrolluar, çdo shkaktim zjarri që mund të zgjerohet në atë mënyrë sa të përfshijë, përpos atij objekti ku ka rënë, edhe më shumë sende përkatësisht objekte, duke qenë me këtë rast jo relevante se në çfarë mënyre është shkaktuar zjarri dhe me cilat mjete është ndezur objekti i zjarrit, siç është e parëndësishme vlera e sendit dhe nëse sendi është në pronësi të kryerësit apo të ndonjë personi tjetër ose bëhet fjalë për një send të braktisur. Vepra është kryer me vetë ndezjen e objektit, kur zjarri ka kapluar objektin në atë mënyrë sa mund të zgjerohet më tej edhe në rast se objekti i mëhershëm i ndezur është mënjanuar nga aty. Andaj, pasi që e pandehura e ka lënë në prizë nxehtësi elektrike e cila kishte qenë në dhomën e gjumit në banesë, e vendosur në prizë përmes një kablllo vazhduese dhe nga ajo është shkaktuar zjarri, me këto veprime janë konsumuar elementet e veprës penale Shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm nga neni 365 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së.

Duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata vërtetoi këtë gjendje faktike: se e akuzuara E.G. (T.), ka kryer veprën penale Shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm nga neni 365 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## **6. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit**

Gjykata me rastin e matjes së dënimit ka vlerësuar që të akuzuarës ti shqiptohet dënim me gjobë në vlerë prej 800 (tetëqind) euro, të cilin dënim e pandehura është e obliguar ta paguajë brenda afatit prej 60 (gjashtëdhjetë) ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, ngase duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat dhe provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës, ky dënim do të jetë i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe përgjegjësinë penale të kryesit dhe si i tillë me këtë dënim mund të arrihet qëllimi i dënimit në kuptim të nenit 41 të KPRK-së. Gjithashtu gjykata me rastin e matjes së dënimit ka marrë për bazë edhe rrethanat që ndikojnë

në llojin dhe lartësinë e dënimit duke u bazuar në nenet 73 dhe 74 të KPRK-së, ashtu që rrethanë lehtësuese për të pandehurën ka marrë faktin se e njëjta është mbajtës e familjes, nënë e një fëmije të mitur dhe gjendjen e dobët ekonomike, kurse rrethanë rënduese gjeti shkallën e dëmit të shkaktuar nga e pandehura.

Andaj, duke u bazuar në të lartcekurat gjykata konsideron se me dënimin e shqiptuar ndaj të akuzuarit mund të arrihen qëllimet e dënimit të parapara në nenin 38 të KPRK-së e që konsistojnë në parandalimin e kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale, të bëjë kompensimin e viktimave ose të komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

## **7. Vendimi lidhur më kërkesën pasurore juridike**

Neni 462 paragrafi 2 i KPP-së përcakton se: *“Në aktgjykim me të cilin i akuzuari shpallet fajtor, gjykata mund të vendosë për kërkesën pasurore juridike të të dëmtuarit në tërësi ose pjesërisht dhe për pjesën e mbetur e udhëzon në kontest civil. Kur të dhënat e mbledhura në procedurë penale nuk paraqesin bazë të sigurt për gjykim të plotë e as të pjesërishtëm, gjykata e udhëzon të dëmtuarin që tërë kërkesën pasurore juridike mund ta realizojë në kontest civil apo të paraqes kërkesë në Programin për Kompensim të Viktimave nëse i plotëson kushtet e atij program”*. Andaj, pasi që nuk kishte një vlerë të saktë të kërkesës pasurore juridike dhe një veprim i tillë do ta zvarriste procedurën penale, gjykata duke u bazuar në dispozitën e lartcekur vendosi që të dëmtuarin Sh.Q. për realizimin e kërkesës pasurore juridike ta udhëzoj në kontest të rregullt juridiko – civil si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## **8.Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale**

Duke pasur parasysh natyrën e kësaj çështje penale gjykata duke u bazuar në nenin 452 paragrafi 1 të KPP-së, ka vendosur që ta detyrojë të pandehurin që të paguaj paushallin gjyqësor në shumën prej 20 (njëzet) euro, si dhe duke u bazuar në nenin 36 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1 të ligjit Nr. 08/L-109, për Kompensimin e Viktimave të Krimin shumën prej 20 (njëzet) Euro. Neni 449 paragrafi 2 nën paragrafi 2.1 i KPP-së përcakton se: *“Shpenzimet e procedurës penale përfshijnë: 2.1. shpenzimet për dëshmitarë, ekspertë, përkthyes, specialistë, stenografim, regjistrime teknike dhe për këqyrjen e vendit”*, andaj është obliguar e pandehura ti

paguaj shpenzimet lidhur me ekspertizën e punuar nga eksperti i elektros në vlerë prej 100 (njëqind) euro.

Andaj duke u bazuar në të lartcekura gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**  
**Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal**  
**2018:063791, me datë 03.04.2024**

**Zyrtarja ligjor,**  
Ardita Tasholli

**Gjyqtari i vetëm gjykues,**  
Dardan Maloku

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i paraqitet Gjykatës Themelore në Ferizaj.